

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 SPORTIT DHE RINISË
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2021
 ME ZGJEDHJE

Qershor 2021

Ora 10:00

Lënda: Sociologji-Filozofi

FI

VARIANTI B

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

1. Për 20 pyetjet me zgjedhje (alternativa), pasi të keni qarkuar alternativën e saktë në test, duhet të mbushni rrathët përkatës të tabelës në fletëpërgjigje.

Lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna në fletëpërgjigje.

2. Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet duhet të shkruhen brenda zonës së kufizuar me vijë. Çdo përgjigje e shkruar jashtë vijave kufizuese, nuk do të vlerësohet.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	3	5	7	8	10	11	12	13	16	18	21	25
Pikët												
Kërkesa	26	28	31	32	33	35	39	40	41			
Pikët												

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Sociologji

1. Ana vinte nga një familje që praktikonte ritualet e Dëshmitarëve të Jehovahit, ndaj ajo nuk u habit kur dëgjoji të flitej për ndalimin e marrjes së gjakut përmes transfuzionit edhe në rastet kur rrezikohej jeta. Në këtë situatë kemi të bëjmë me: **1 pikë**

- A) shok kulturor.
- B) ritual fetar.
- C) socializim.
- D) shekullarizim.

2. Shqipëria është si një mozaik për nga larmia e veshjeve nga njëra krahinë në tjetrën, që shfaqet me modele të veçanta në prerje dhe stoli përkatëse. Kjo veçori lidhet me: **1 pikë**

- A) normat kulturore.
- B) vlerat kulturore.
- C) nënkulturën shqiptare.
- D) relativizmin kulturor.

3. Argumentoni një prirje të zhvillimit të kulturës shqiptare si kundërkulturë përgjatë historisë? **1 pikë**

4. Qarkoni pohimin e saktë, që lidhet me ndikimin e përvojës shoqërore në formimin e personalitetit të individit. **1 pikë**

- A) Personaliteti i individit krijohet nga izolimi ndaj ndikimit të jashtëm.
- B) Çdo individ zhvillon sjelljen e tij pavarësisht ndërveprimit me të tjerët.
- C) Personaliteti i individit nuk mund të zhvillohet jashtë përvojës shoqërore.
- D) Çdo individ përforcon vlerat personale pa patur nevojën e modeleve të sjelljes.

5. Bazuar në mendimin e sociologut Uilliam G. Sumner, shpjegoni lidhjen midis normave kulturore dhe normave ligjore. **2 pikë**

6. "Krimi pa viktima" përfshin: **1 pikë**

- A) grabitjen me dhunë
- B) prostitucionin ilegal
- C) paragjykimin
- D) shkatërrimin e pasurisë

7. Si realizohet përfytyrimi i vetes në raport me të tjerët, bazuar në teorinë e sociologut Çarls H. Kuli? **1 pikë**

8. Analizoni në aspektin historik karakterin relativ të deviancës në dukurinë e gjakmarrjes në Shqipëri. **2 pikë**
- _____
- _____
- _____
9. Në universitetin e Alabamës në SHBA, deri në vitin 1962, nuk lejohej regjistrimi i studentëve me ngjyrë. Ky fakt ka të bëjë me: **1 pikë**
- A) diskriminimin institucional.
B) stereotipin me bazë raciale.
C) paragjykimin me bazë raciale.
D) asimilimin e pakicave.
10. Joni dhe Era kanë studiuar në të njëjtën degë në fakultet. Era ishte një studente e shkëlqyer dhe gjithnjë e kishte ndihmuar Jonin me detyrat e kursit. Sot ata punojnë në të njëjtin institucion dhe Joni është drejtor i saj. Angazhimi i Erës si amvisë dhe nënë e një vajze të vogël ia kufizon kohën, ndaj ajo nuk ishte e pranishme në festën e fundvitit me kolegët. Identifikoni tre drejtimit kryesore ku shfaqet pabarazia gjinore në këtë situatë. **3 pikë**
- a) _____
- _____
- b) _____
- _____
- c) _____
- _____
11. Analizoni marrëdhëniet mes shumicës dhe pakicave etnike në shoqëritë moderne, bazuar në formën më të skajshme të etnocentrizmit. **2 pikë**
- _____
- _____
- _____
- _____
12. Fetë kanë qenë dhe janë të shumëllojshme. Bazuar në kuptimin sociologjik të fesë, sipas sociologut Emil Dyrhejm, dalloni dy tipare të përbashkëta për të gjitha besimet fetare: **2 pikë**
- a) _____
- _____
- b) _____
- _____
13. Shpjegoni një faktor që përforcoi prirjet shekullarizuese në vendin tonë, zhvilluar pas Luftës së Dytë Botërore deri në fundin e viteve 1980. **1 pikë**
- _____
- _____
- _____

14. Termi meritokraci lidhet me vlerësimin sipas:

1 pikë

- A) aftësisë.
- B) lidhjeve miqësore.
- C) trashëgimisë familjare.
- D) mirëqenies ekonomike.

15. Lisbona po konsiderohet si një mjedis urban që po zhvillohet shpejt. Qendra e qytetit po shfaqet si hapësirë krijuese që tërheq kryesisht të rinjtë e mirëarsimuar, e shoqëruar gjithashtu me rritjen e çmimeve të banesave. Për këtë arsye, një grup protestuesish kanë shprehur pakënaqësi. Ky rast lidhet me prirjen urbane të:

1 pikë

- A) shpërqendrimin urban.
- B) përtëritjes urbane.
- C) xhentrifikimit.
- D) eksurbanizimit.

16. Krahasoni një nga veçoritë e punës në shoqëritë më të industrializuara, me rastin e Shqipërisë.

2 pikë

17. Besimi se "progresi teknologjik, jo përherë sjell përparim në jetën e njerëzve" si karakteristikë, i shkon përshtat shoqërisë:

1 pikë

- A) totalitare
- B) paramoderne
- C) moderne
- D) pasmoderne

18. Shpjegoni dy veçori të sistemit të kastave.

2 pikë

1. _____

2. _____

19. Efekti hauthorn evidentohet në metodën e kërkimit sociologjik të:

1 pikë

- A) eksperimentit.
- B) vëzhgimit jopjesëmarrës.
- C) anketës.
- D) studimit të dokumentave.

20. Sipas Peter Bergerit, pasurimi i spektrit të shumëllojshmërisë shoqërore ka si veçori orientimin kah botëkuptimit:

1 pikë

- A) fetar
- B) shkencor
- C) tradicional
- D) postmodern

21. Studimi sociologjik kërkon të masë shkallën e respektimit të masave anti-Covid në një qendër të madhe tregtare. Ai ka si synim të kryhet, vetëm në dyqanet e veshjeve. Vlerësoni duke argumentuar cila nga metodat sociologjike do të ishte më e përshtatshme në këtë rast? 2 pikë

QSHA 2021

Filozofi

22. Shprehja e Aristotelit: "Njeriu është një kafshë (qenie) politike" nënkupton se: 1 pikë
- A) njeriu merret me politikë për t'u cilësuar si i tillë.
 B) njeriu merret me politikë për të arritur virtytin.
 C) njeriu përdor politikën për të synuar lumturinë.
 D) njeriu është i lidhur thelbësisht me shtetin.
23. Mendimi filozofik në Greqinë e lashtë lindi si përpjekje për të shpjeguar dukuritë natyrore dhe shoqërore. Një nga tiparet që karakterizoi këtë mënyrë arsyetimi, ishte: 1 pikë
- A) besimi te ekzistenca e zotave që kontrollojnë natyrën.
 B) bindja ndaj rregullit rigoroz që vendos fatin e njerëzve.
 C) soditja e universit të krijuar sipas mitologjisë tradicionale.
 D) hulumtimi i vërtetë dhe i lirë i çështjeve bazë të ekzistencës.
24. Sipas shkollës së skeptikëve lumturia arrihet përmes: 1 pikë
- A) heqjes dorë nga çdo gjykim.
 B) zvogëlimit të nevojave.
 C) kënaqësisë fizike.
 D) mungesës së frikës nga vdekja.
25. Përcaktoni ndarjen e realitetit në dy pjesë sipas Platonit. 2 pikë
-
-
-
26. Shpjegoni qëndrimin e stoikëve për ligjet e pathyeshme të natyrës. 2 pikë
-
-
-
27. Filozofia e Kampanelës, gjatë periudhës së Rilindjes Europiane, u karakterizua më së shumti nga: 1 pikë
- A) ateizmi.
 B) utopizmi.
 C) skepticizmi.
 D) materializmi.
28. Plotini mendonte se bota ishte e ndërtuar sipas një rendi hierarkik. Në krye të piramidës qëndronte forca superiore ose Njëshi, që ai e krahasoi me dritën që buron nga dielli. Identifikoni tre funksione të Njëshit, sipas kësaj filozofie: 3 pikë
- a) _____
 b) _____
 c) _____

29. Në filozofinë e Bekonit pranohet se:

1 pikë

- A) feja është e lidhur ngushtë me shkencën.
- B) natyra njihet përmes shkencës.
- C) e vërteta njihet përmes metodës deduktive
- D) mendimi duhet të bazohet në autoritetin e traditës.

30. Filozofia dualiste e Dekartit pranon se:

1 pikë

- A) Zoti dhe natyra janë dy koncepte të shkrira në një.
- B) njeriu dhe Zoti janë dy koncepte të ndryshme.
- C) dyshimi dhe arsyeja janë dy elementët kryesor tek njeriu.
- D) realiteti i mendimit dhe i lëvizjes janë pjesë e njeriut.

31. Argumentoni pse Akuini si teolog, mendonte se besimi dhe arsyeja nuk bien ndesh me njëra-tjetrën.

1 pikë

32. Shpjegoni dy cilësi që dallojnë qytetin e Zotit dhe qytetin tokësor tek Shën Agustini.

2 pikë

1. _____
2. _____

33. Argumentoni se përse "ndërgjegjja është e zbrazët përpara se të perceptoj diçka", sipas Lokut.

1 pikë

34. Filozofi iluminist Zhan Zhak Ruso, ishte nga të parët që theksoi lidhjen mes pabarazisë shoqërore dhe lindjes së pronës private, e cila sipas tij sollti:

1 pikë

- A) barazi dhe harmoni mes njerëzve.
- B) zhvillim dhe mirëqenie për të gjithë.
- C) ndarjen në klasa dhe luftën mes tyre.
- D) bashkëpunimin mes grupeve shoqërore.

35. Sipas Spinozës, "Zoti është shkaku dhe thelbi i gjithçkaje që ekziston". Shpjegoni dy aspekte të këtij pohimi, që japin përmbajtjen e teorisë së tij për Zotin:

2 pikë

- a) _____
- b) _____

36. Koncepti i "mbinjeriut" për Niçen nënkupton njeriun: 1 pikë
- A) me fuqi të mbinatyreshme.
 B) që kapërcen vetveten.
 C) që evoluon biologjikisht.
 D) me vlera dhe parime fetare.

37. Hegeli, në veprën "Filozofia e shpirtit", paraqet idetë e tij për historinë e shoqërisë. Sipas filozofit, njerëzimi është zhvilluar përmes ligjeve të dialektikës, që shprehin: 1 pikë
- A) ekuilibrin e pandryshuar të mendimit njerëzor.
 B) gjykimet përfundimtare të moralit të shoqërisë.
 C) ekzistencën e ngjarjeve si të dhëna faktike të ngurta.
 D) kalimin nga rende shoqërore më të ulta, në ato më të larta.

38. Tek mendimi i Hajdegerit, koncepti "ekzistencë" përfshin: 1 pikë
- A) ekzistencën e njeriut në botë.
 B) ekzistencën e sendeve në botë.
 C) ekzistencën e njeriut dhe sendeve në botë.
 D) ekzistencën e Zotit si qenie supreme në botë.

39. Bazuar te Kanti, krahasoni imperativin kategorik me imperativin hipotetik. 2 pikë

40. Një djalë i ri është në dilemë: të zgjedh të shkojë në luftë për t'i shërbyer një kauze që besonte ose të zgjedh të qëndroj me nënën e tij të moshuar. Ai mund të qëndronte me nënën duke i lënë të tjerët të luftonin, ose të shkonte në luftë dhe të linte nënën vetëm. I riu ndjeu përgjegjësi në të dy situatat. Argumentoni mbi lirinë për të zgjedhur bazuar në dy aspekte të mendimit të Sartrit. 2 pikë

1. _____

2. _____

41. Marksi është shprehur se: "Deri tani filozofët vetëm e kanë interpretuar botën, por çështja është si ta ndryshosh atë". Vlerësoni më poshtë, dy momente të rëndësishme të rolit të filozofisë, dhe klasën që do të sillte këtë ndryshim, sipas tij: 3 pikë

a) Misioni i filozofisë _____

b) Rruga e ndryshimit shoqëror _____

c) Klasa që do të sillte ndryshimin ishte: _____